



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 24/2015

Prishtinë, më 7.7.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha - Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Hanefi Muharremi, zv.ministër i Infrastrukturës, Avni Kastrati, zv. ministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ramë Qupeva, Avdi Kamerolli, Xhemë Veseli, Lulzim Rama, dhe Jakup Hoti - Ministria e Infrastrukturës; Irfan Lipovica - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Shkëlzen Kuqi – Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Mimoza Gojani - Ambasada e Britanisë së Madhe; Qëndresë Mustafa - BIRN; Visar Berisha dhe Dardan Abazi - INDEP; Fatmir Berzati- NGO Durchkalten; Kaltrina Ahmeti - GLPS; Arta Krasniqi - OSBE; Besa Berisha, Arta Xhylani dhe Arbana Pireva - UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 30.6.2015;
3. Raportim i përfaqësuesve të ministrive të linjës lidhur me realizimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i Progresit:
 - a) Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
 - b) Ministria e Infrastrukturës;
 - c) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
4. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.6.2015;

Procesverbal i mbledhjes së mbajtur më 30.6.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i përfaqësuesve të ministrive të linjës lidhur me realizimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i Progresit;

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se sipas planit të punës së Komisioni, ne kemi konstatuar që të zhvillojmë debat para se të vijë Raporti i Progresit, të shohim se ku janë problemet me zbatimin e sfidave që paraqiten lidhur me fushën e integriteteve evropiane. Qëllimi i këtij takimi është që të bëhet një vlerësim i masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për të kaluar problemet kyçe në fushën e integriteteve evropiane, ku pjesa më e madhe është evidentuar si sfida në Raportin e Progresit. Kërkoj nga Qeveria të përqendrohen në pikat kyçe se si të bëhet rritja ekonomike, vlerësimet e reja për rritjen ekonomike; problemet e rregullimit të tregut; aftësitë konkurruese ose konkurrenca; ndërmarrje publike problemet që i kemi me to; kompletimet që kanë të bëjnë me agjencitë e ndryshme dhe organizata e pavarura; problemet e vonesave lidhur me energjinë ripërtëritëse; objektet e reja; rregullimin e tregut problemet me cilësinë e produkteve që lidhen me konkurueshmërinë; aplikimi i standardeve, agjencitë e akreditimit të standardeve lidhur me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve. Këto janë sfida që janë evidentuar në Raport dhe kishim dashur që të dimë se çka ka ndodhur dhe çfarë mund të bëhet në kohën që ka mbet deri në Raportin e ri, që Kosova të merre një vlerësim sa më pozitiv. Këto janë çështjet kyçe të cilësisë të jetesës dhe demokracisë dhe të zhvillimit të shpejtuar të Kosovës.

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, tha se diskutimi i parë në kuadër të Raportit të Progresit nga MZHE-ja, është për energjinë pasi që është pjesa më e madhe e këtij raporti, edhe lidhet me projektin e Kosovës së Re, me Kosovën A, dhe me energjinë e Ripërtëritshme. Ne jemi duke punuar në katër prioritetet që mund të konkretizohen në formën e projekteve, projekti i Kosovës së Re paraqitet njëra nga sfidat për ecurinë e projektit. Nga 19 dhjetori i vitit të kaluar dhe deri më tani ne kemi kaluar disa nënfaza të këtij procesi, dhe se pika e fundit që ka mbet të diskutohet është çështja e normës së brendshme të kthimit në ekuitet sidomos impakti i saj social që kemi një mision këto ditë të Bankës Botërore. Ne kemi interesim të shprehur në mënyrë eksplicite nga kompani të njohura botërore në fazën e dytë që ajo të jetë ndërtimi i termocentralit. Disa prej tyre janë paraqitur tek ne dhe disa të tjerë tek investitori amerikan, dhe se ne po flasim për kompani kryesisht gjermane, amerikane, italiane po ashtu ka interesim edhe të atyre japoneze dhe të Koresë së Jugut. Prioriteti i dytë është dekomisionimi i Kosovës A. Ju e dini që KEK-u ka bërë një varg përpjekjesh dhe një pjesë e madhe ka rezultuar e suksesshme, kanë mbetur disa detaje të tjera në remontin e njësive të cilat kanë qenë të prekura pas këtij shpërthimi dhe se situata momentale është stabile, dhe fatmirësisht vitin e kaluar nuk kemi pasur problem të shtuara. Te burimet ripërtëritëse kemi avancime konkrete dhe kemi dy projekte që tash kanë marrë rrugën e zbatimit; projekti i Bankës Botërore, kredia që është ratifikuar në Kuvend për eficiencën 31 milionë dollarë dhe është nënshkruar manuali për operimin dhe projekti ka marrë formën e efektivitetit dhe jemi në fazën e zbatimit të tij. Në nivelin lokal janë kryer planet për zbatimin e eficiencës në 19 komuna. Gjithashtu kemi bërë përgatitjen e një fondi të eficiencës, ku disa prej operatorëve na kanë prezantuar pas studimit të fizibilitetit, ku ne e kemi kërkuar në tri dimensione, atë ligjor, financiar dhe teknik për të pasur një fond të eficiencës, i cili do të jetë komplementar me këto dy fonde të tjera. Çështje tjetër është ajo për pakon e ligjeve, pakon e tretë të ligjeve të energjisë elektrike, rregullatori, dhe gazi dhe

nëse kësaj i shtojmë edhe atë të efijencës, le të themi një pako totale prej pesë ligjeve, të cilën Kuvendi duhet ta aprovojë sivjet, e që do të kenë impakt të madh në fushën e energjisë sidomos për sa i takon liberalizimit të tregut, dhe për sa i takon rregullatorit të energjisë. Stavileci tha se ne do ta kemi kodin tone telefonik dhe pastaj ka një periudhë të migrimit të kodeve të prefiksit të tjera në kodin telefonik +383, mirëpo, ka ende disa fjali apo pozicionime të cilat ne duhet t'i qartësojmë nga aspekti politik ndërsa nga aspekti ekonomik, sidomos nga benifitet që ne do ta kemi kodin tone është i padiskutueshëm. Pjesa e fundit është për telekomunikacionin dhe se janë paraqitur dy sfida që kanë të bëjnë me Strategjinë dhe me Ligjin për digjitalizimin, që ne e kemi trajtuar, i cili ka kaluar në leximin e parë në Kuvend. Çështja tjetër është për ndërmarrje publike - ligji për ndërmarrje publike, rrethanat na imponuan që të merremi me çështje tjetër dhe të adresojmë një çështje krejt tjetër, mirëpo, ne jemi duke punuar dhe ideja jonë është që të kemi një ligj të ri dhe të gjitha defektet që janë paraqitur ndër vite, do të mundohemi që t'i përmirësojmë. Në përputhje me KASH-in dhe në koordinim me FMN, Qeveria ka bërë reduktimin e subvencioneve edhe në vitin 2013, në krahasim me vitin paraprak, duke zbritur subvencionet që më 2012 ishin: 23.696 milionë euro, në 2013 në 21.484 për 11% dhe në 2014, në 9.7 milion euro apo në relacion me 2012 më pak për 58% dhe në relacion me 2013, rënie te subvencionimit të NP-ve për 54%. Në të ardhmen do të zvogëlohen subvencionet për ngrohje qendrore, pasi projekti i koogjenerimit ka filluar së funksionuari. Ne nuk po flasim vetëm për ndërmarrje publike, por edhe lokale që gjithsej janë 43, që ne do ta ndryshojmë një rregullore, në mënyre që të mos i ndajmë fushat se ku duhet të ndërtojmë ndërmarrjet publike, ku ndërmarrjet private e ku PPP - Partneritet Publiko Privat, në mënyrë që ato të jenë të qëndrueshme, theksoi Stavileci.

Hanefi Muharremi, zv.ministër i Infrastrukturës, the se transporti rrugor është duke u bazuar në rrjetin e transportit transevropian, ku Kosova ka vazhduar të participojë në mënyrë aktive në implementimin e Memorandumit të mirëkuptimit (2004) për zhvillimin e rrjetit të transportit rajonal për Evropën Juglindore në kuadër të SEETO-s. Segmentet 1-9 të autostradës Morinë-Merdar (R7) janë inauguruar në nëntor të vitit të kaluar, kurse për segmentin e fundit të autostradës (Besi- Merdar) është siguruar grandit nga WBIF për studimin e fizibilitetit. Kontrata në vlerë prej 600 milionë eurosh për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Shkup (R6) është nënshkruar në korrik të vitit të kaluar dhe dinamika e punëve është duke u zhvilluar sipas planit. Strategjia e Transportit Multimodal, me rekomandim të Zyrës për Planifikim Strategjik të ZKM-së, është fuzionuar me Strategjinë sektoriale të MI-së. Aktualisht jemi duke rishikuar pjesën narrative të strategjisë së fuzionuar dhe shpresoj që shumë shpejt do ta procedojmë në Qeveri për aprovim. Sa i përket transportit hekurudhor tha se nëpërmes instrumentit të WBIF (Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor) është paraparë rikonstruimi i linjës hekurudhore Hani i Elezit-Leshak, në vlerë prej 180 milionë euro, nga cilat 50 % do të jenë grande, ndërsa pjesa tjetër do të financohet me kredi nga BERZH-i. Sa i përket investigimit të aksidenteve, është themeluar Zyra për Investigimin e Aksidenteve, e cila është vendosur në Zyrën e Kryeministrit, dhe jemi në proces të funksionalizimit të plotë. Transporti Ajror është bërë kërkesa për implementimin e fazës së parë të Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Ajrore Evropiane është afër kompletimit, ka mbetur vetëm harmonizimi i Ligjit të Punës i Republikës së Kosovës, me disa dispozita të direktivës së Bashkimit Evropian për orarin e punës. Në mars të vitit të kaluar Kuvendi ka aprovuar Ligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimin e Navigimit Ajror, duke përcaktuar mënyrën e funksionimit të saj. Me qëllim të implementimit të Ligjit për shërbimet e navigimit ajror, Ndërmarrja Publike Aeroporti “Adem Jashari” duhet të shndërrohet në agjenci qeveritare mbi shërbimet e navigimit ajror. Sa i përket sigurisë në trafik , Strategjia për siguri në Komunikacionin Rrugor, pas hartimit të draftit final dhe rishikimit nga Zyra për Planifikim Strategjik e ZKM-së përgjatë muajit korrik, strategjia do t'i dërgohet sekretarit Koordinues të ZKM-së për ta proceduar në Qeveri për miratim. Gjithashtu, Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, është vendosur që të ndahet në tri ligje: ligji për patentë shofer, ligji për

pjesëmarrje në komunikacion dhe ligji për automjete, të cilat do të procedohen në Kuvend gjatë këtij viti.

Avni Kastrati, zv.ministër i Tregtisë dhe Industrisë-Ne në raport kemi bërë renditjen në bazë të kapitujve, ku në pjesën e parë i kemi hyrjet dhe daljet në treg dhe në kuadër të hyrjeve dhe daljeve në treg nga ne është kërkuar që të rriten kapacitetet administrative. Të gjithë ne e dimë se më e mira është që me i rritë ato kapacitete, mirëpo, jemi të lidhur me numrin e të punësuarve dhe kjo ka ndikim buxhetor. Neve na është adresuar se kemi një qasje të dobët në financim në sektorin privat dhe mund t'ju informojë se është kjo një informatë e re, përafërsisht para dy muajsh është kryer projekti i cili ka qenë projekt prej 4 (katër) milion euro, në të cilin 3 (tre) milion euro ka qenë donacion i BE-së, ndërsa 1 (një) milion euro i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kastrati tha se për ndërmarrjet e mesme janë 15 përfitues në vlerë prej 2 milion e 465.267 euro, ku këta 15 përfitues kanë projekte të ndryshme. Nga bizneset e vogla, gjithsej kanë përfituar 36 biznese dhe vlera e tyre është 2 milion e 933.999 euro. Për bizneset mikro, vlera ka qenë prej 10-25 mijë euro, ndërsa për bizneset e mesme vlera ka qenë prej 60 - 200 mijë euro. Lëvizja e lirë e mallrave është kërkuar që ta rritë stafin nëpër agjencitë relevante, mirëpo, kjo është e lidhur me të parën që e shpjegova, për me e rrit stafin duhet buxhet. Te standardizimi, na është kërkuar që të kemi më shumë aktivitete në ngritjen e vetëdijes së bizneseve në përpunimin e standardeve. Në kuadër të kësaj, ne kemi punuar shumë duke organizuar punëtori të ndryshme nëpër qendra më të mëdha, fatmirësisht kemi pasur suksese në këtë fushë. Kastrati tha se te metrologjia, ka qenë kërkesë që të bëhet avancimi në funksionalizimin e mjeteve të laboratorëve dhe prapë kjo është e lidhur me mundësitë financiare, mirëpo, jemi të vetëdijshëm dhe jemi duke punuar në këtë drejtim. Rreth akreditimi është kërkuar nga ne akreditimi Evropian. Ne kemi marrë aktivitetet që të konkurrojmë, kanë ardhur ekipet që t'na vlerësojnë dhe i kanë marrë informatat themelore. Neve na mbetet të punojmë, në mënyrë që të avancojmë, të akreditohejmë me qëllim që t'ua lehtësojmë të tjerëve që të jenë të akredituar dhe të kenë efekte më pozitive në treg. Rreth inspektoratit, na është kërkuar përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit të institucioneve relevante. Te inspektorati është një specifikë se komunat kanë inspektorate, me ligj të gjithë inspektorët duhet të kalojnë në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë, mirëpo, kjo nuk realizohet me tepër se 7 vjet. Te shërbimet, neve na është kërkuar që të kemi një adaptim të një ligji horizontal të shërbimeve ose vazhdimi i identifikimit të zbrazësisë ligjore në lëvizjen e shërbimeve. Është duke u hartuar koncept - dokumenti, konkretisht janë duke u adresuar komentet e pranura nga institucionet tjera relevante. Për të drejtat e Pronës Industriale, jemi të stërngarkuar prej kërkesave të bizneseve dhe prodhueseve. Kemi pasur edhe kërkesa që kanë qenë në pritje mirëpo, kohën e fundit gjashtë punëtor janë duke u marr me këto kërkesa dhe jemi duke punuar në këtë drejtim. Në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë, na është kërkuar aplikimi, jemi duke i bërë përgatitjet mirëpo, ende kemi dilemë se a do të dërgojmë kërkesën që të jemi vëzhgues apo të jemi anëtar i plotë, ngase nëse e bëjmë kërkesën si anëtar i plotë dhe refuzohemi, atëherë duhet një periudhë shumë e gjatë kohore për aplikim të serishëm. Te kapitulli i industrisë dhe NVM-së na është kërkuar që të bëjmë regjistrimin online të bizneseve dhe kjo mund të realizohet në vitin 2016, mirëpo, ka implikime buxhetor por jo shumë të mëdha. Gjithashtu, nga ne është kërkuar një monitorim i implementimit të strategjisë për zhvillim të sektorit privat për periudhën 2013-2017 dhe plani i veprimit dhe në këtë drejtim po punohet. Sa i përket progresit të limituar në politikën industriale dhe të NVM-ve, kërkojnë punë më shumë dhe edhe ne si Ministri dalëngadalë në atë drejtim po avancojmë dhe me përkrahjen e UNDP –së kemi pasur një projekt për ndihmë tregtisë, janë hartuar dhe publikuar studimet për tregjet potenciale për eksport dhe mendoj që është e rëndësishme për arsye se ne do të mundohemi të sjellim investitorë të huaj, theksoi Avni Kastrati.

Blerim Grainca- Në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, një mori probleme janë të trashëguara nga e kaluara, megjithatë kërkojnë një zgjedhje të shpejt dhe akute. Problem prezent si për qeverinë ashtu edhe për institucionet tjera mbetet çështja e energjisë. Unë si deputet nuk

kam pas informata të mjaftueshme me vonesat që po shkaktohen rreth termocentralit Kosova e Re, mirëpo, jemi të vetëdijshëm se ky projekt ka pësuar ndryshime kohet e fundit varësisht nga bindjet politike, nga interesa të caktuara, mirëpo, do të ishte në interes që kjo punë të kryhet sa më shpejt. Po ashtu, projekti tjetër që është diskutuar mjaft është dekomisionimi apo tani ideja e re për rikonstruktimin e termocentralit aktual “Kosova A”. Do të ishte në interes që ta dimë se deri ku ka mbërritur çështja rreth kësaj. A është duke u diskutuar për projektin nga kompania “Bilfinger” dhe a po rrezikon Kosova nëse nuk pranohet ky projekt të hyjë në atë “Gep-in”, që të kemi mungesë të energjisë nga viti në vit, nga viti 2017 e deri në vitin 2021. Nëse hymë në atë fazë të mungesës së energjisë, që kryesisht do të varet nga importi, atëherë do të rrezikohen edhe të gjitha projektet tjera që lidhen edhe me fusha tjera që kanë të bëjnë me investime edhe me projektet tjera zhvillimore. Lidhur me rritjen e investimeve në burimet e ripërtëritëse, dy projekte që i përmendi ministri që janë në zhvillim, mendoj që nuk e mbulojnë sa duhet se jemi larg rritjes së objektivit për 25% të energjisë rinovuese deri me fazën që të arrihet kjo. Një sfidë tjetër që ishte ndërhyrja e qeverisë në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, qoftë përmes kufizimeve buxhetore apo implikimeve tjera, mendoj që kjo është pak e zmadhuar se sa reale. Çështjet që lidhen me shoqërinë informative dhe me teknologjinë informative. Ne si komision jemi marr me çështjet e digjitalizimeve, mirëpo, ka pasur një draft që ka shkakuar një luftë në mes KPM-së dhe ARKEP-it për ngatërrimin e kompetencave për bartjen e kompetencave nga një agjenci në tjetrën dhe se kjo çështje me ligj tashmë është rregulluar. Te Ministria e Infrastrukturës, për mua është shqetësuese çështja që lidhet me sigurinë rrugore për shkak të pasigurisë rrugore, duke u bazuar në statistikat e pasluftës. Këtu kemi dy elemente; standardi dhe kualiteti i dobët i rrugëve si dhe dhënia pa kriter të duhur të patentë shoferëve apo licencimi i shoferëve të rinj pa ndonjë kriter të caktuar. A janë siguruar apo ende mbetet si sfidë sigurimi i mjeteve për vazhdimin e segmentit rrugor në Merdar dhe a është definitive rruga që do të kalojë në të majtë apo në të djathtë si dhe rruga që do të kalojë me Shkupin? Grainca pyeti edhe për çështjen e hekurudhave, se a është bërë diçka me projektin që do ta lidh Kosovën me Shqipërinë, gjegjësisht në portin e Durrësit. Rreth Ministrisë së Tregtisë, rreth ligjit të investimeve të huaja, tha se kjo ministri nuk ka mundur të përmbushë qëllimet kryesore që lidhen me ngritjen e shkallëve të investimeve në Republikën e Kosovës para investitorëve të huaj. Çështje tjetër tek kjo ministri e përmendi çështjen e naftës në mungesën apo sjelljen ligjit të naftës në Kuvend, gjegjësisht në komision dhe tha se është shqetësuese edhe kontrolli i naftës për kualitetin dhe për sasinë.

Raif Qela- Meqenëse jemi duke i shqyrtuar në përparimet që janë bërë në Raportin e Progresit, meqenëse Kosova ndër problemet kryesore të saj e ka energjinë, fokusohem edhe unë vetëm në energjinë, atëherë pyetjen do t ia bëjë vetëm ministrit të Zhvillimit Ekonomik. E përmendi edhe kolegu më parë se çështja e furnizimit me energji elektrike është çështje mjaft sfiduese për Kosovën, është sfiduese edhe për shkak se është kërkuar nga Bashkimi Evropian që Kosova ta dekomisionojë “Kosovën A”. Si pasojë e kësaj, Kosova rrezikon të ketë një zbrazëti të madhe, me mungesë të madhe të energjisë në dy vite në vazhdim, së paku nëse çdo gjë shkon në rregull me “Kosovën e Re”, prandaj, po e sforcuj edhe njëherë pyetjen e kolegut deputet më parë, se si e konsideron Qeveria dhe Ministria përkatëse, cila është rruga që të mos vijë deri te kjo zbrazëti në furnizim me energji? Kërkoj nga ministri që të na sqarojë se a është diskutuar në Qeveri projekti për ripërtëritjen ta quaj kështu kushtimisht të “Kosovës A”, se a është përmendur projekti i cili është përmendur edhe në mjetet e informimit gjatë vizitës së kryeministrit Mustafa në Gjermani që “Bilfinger” të jetë kompania dhe operatore e mundshme për ripërtëritjen e “Kosovës A”. A janë këto dy projekte kompatible ndërmjet vete apo janë në konflikt ndër vete, sepse është me interes të që të dihet kjo punë. Ne duhet ta gjejmë mënyrën më të mirë që të furnizohemi me të, pa e degraduar ambientin për shkak se sipas rregulloreve ekzistuese të Bashkimit Evropian dhe sipas kërkesave të tyre që burimet ripërtëritëse të jenë 25% për Kosovën dhe kjo është mjaft sfiduese. Kërkesa për ta plotësuar këtë kriter për Kosovën është tepër e shtrenjtë dhe e vështirë, që kjo të realizohet me projektet e burimeve ripërtëritëse në

Kosovë, sepse mundësitë janë tepër të kufizuara. Edhe energjia solare, edhe energjia me erë edhe hidroenergja në Kosovë mund të bëhen vetëm duke e degraduar ambientin. Njëra prej mundësive të mëdha të Kosovës që ta plotësojë edhe këtë kriter është që të bëhet integrimi i energjetikës së Republikës së Kosovës me atë të Republikës së Shqipërisë, e që është përmendur shumë në opinion, e që do ta zgjidhte edhe problemin edhe të këtij kufiri me burime ripërtëritëse, sepse dihet mirëfilli se Republika e Shqipërisë ka burime të mjaftueshme të hidroenergjisë, kurse Republika e Kosovës atë të termooenergjisë dhe këto burime e plotësojnë njëra-tjetrën; Shqipëria ka mjaft ujë dimrit, ndërsa verës ka mungesë tepër të madhe të energjisë dhe Kosova ka tepërcë të energjisë gjatë verës. Vetëm integrimi i kësaj fushe me interes shumë të madh për Republikën e Kosovës dhe për Republikën e Shqipërisë dhe kjo do ta rregullonte për 20% më mirë fushën e energjetikës, sepse do të ishin shpenzimet shumë më të vogla dhe nuk do të kishim nevojë që të marrim energji me çmime tepër të shtrenjta në kohën kur nuk kemi kontrata etj.

Besim Beqaj tha se si parim në bazë të agjendës të cilën e kemi përpara, e kemi lexuar për të diskutuar mbi sfidat e Raportit të Progresit dhe jo mbi politikat qeveritare të përgjithshme e këtë po e them edhe për ministrat edhe për deputetët. Ne e kemi një dokument përpara vetes të cilin do ta dërgojmë në Bruksel, ku ministrat e kanë për obligim deri me një datë të caktuar dhe gjuha e Raportit të Progresit nuk njeh as “duhet”, as “do ta bëjmë” por do t’i njeh rezultatet konkrete. Ne këtu diskutuam për politikat reale për energjinë deri tek integrimi i tregut, deri tek futja e një operatori të ri, por janë do standarde të nivelit ndërkombëtar, nuk është në gatishmëri vetëm një kompani të paraqet një interesim pavarësisht prej atij interesimi ne tash të veprojmë, ne kemi një bashkëpunim me një komision evropian, i cili për secilën ministri veç e veç ka dhënë sfida. Raportet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë janë në korrekte, që janë bërë sipas paragrafëve dhe sfidat që janë adresuar, ndërsa raporti që ka ardhur nga Ministria e Infrastrukturës, nuk i plotëson kriteret, është raport i përgjithësuar. Nëse ka problem me hyrje në treg, nëse ka problem me mungesë të kapaciteteve, këta janë hapat të cilët do t’i marrim ne dhe do të kërkojmë përkrahjen e Kuvendit. Këto janë gjerat që i kam pritur dhe po e them që kuptim e ka humbur së paku nga këndvështrimi i im vlerën, sepse unë do të isha shumë i lumtur që ne secilën ministri të takohemi dhe të diskutojmë për politikat e përgjithshme. Raporti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, është përgjigjur në mënyrë konkrete për secilën edhe për kundër asaj që në kuadër të sektorit për energji ka gjera që nuk janë kompetencë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Kërkoj që raportet të jenë sa më konkrete nga të gjitha ministratë.

Pal Lekaj tha se edhe unë kam pritur nga ministratë më shumë që të adresohen sfidat dhe përmbyllja e rekomandimeve nga linjat ministrore përkatëse. Është bërë problem në vete, ngase 90% e ndërmarrjeve publike nuk janë profitabile dhe nuk janë të qëndrueshme, si dhe nuk ka borde të kompletuara. Është përmendur si sfida edhe subvencionimi që përmendet me të drejt, por cila është rruga që do ta ndjekë Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kemi sfida edhe të raporteve ndër-institucionale në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe të Ministrisë së Ambientit, por sa i përket karbonit që është ndotje e ambientit dhe në këtë drejtim nuk e pamë se çka do të ndërmerret që të tejkalohet kjo sfida. Në Raportin e Progresit me rezervat e naftës, nuk pamë diçka, nuk pamë një strategji apo një plan veprues me një datë të caktuar për monitorim. Ndërsa, sa i përket infrastrukturës dhe standardizimi që kërkohet nga BE-ja, duke filluar nga hekurudhat, të cilat dihet se në çfarë gjendje janë, ne pamë këtu një raport të politikave zhvillimore, por jo një raport të rekomandimeve të Raportit të Progresit.

Blerim Grainca- Deputeti Beqaj nuk është i thirrur e as nuk është vendi për të dhënë komente rreth diskutimit të kolegëve deputetë, për arsye se këtu kemi të bëjmë me një raport të ministrave

përkatëse, sepse nuk mendoj që janë fushatë elektorale çështjet që lidhen me energjinë, që është problemi kyç i këtij vendi. Çështjet që lidhen me rrugët, sigurinë e rrugëve apo me çështjen e investimeve. Mendoj që deputeti Beqaj, do të ishte mirë të ishte këtu se shumë nga këto probleme janë probleme të trashëguara nga Qeveria e kaluar dhe nëse nuk gabo, tri herë ka qenë ministër deputeti Beqaj, prandaj do të ishte mirë të ishte këtu.

Raif Qela- Dua të jep një sqarim lidhur me atë që e tha deputeti Beqaj. Krejt ajo që diskutova është në përputhje me dokumentin e fundit të Raportit të Progresit për Kosovën. Në faqet 51-52, janë të adresuara këto çështje që kanë të bëjnë me energjinë. Mungesa e energjisë edhe vonesa e projektit për “Kosovën e Re” edhe mundësia, që ka shumë pak gjasa këto që të përmbushen sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, për të zbatuar Direktivën e impiantit me djegieje të lartë dhe nuk e ka përgatitur Planin Kombëtar për emetim, siç kërkohet me këtë Direktivë. Lidhur me nevojën për energji ripërtëritëse, të cilën Kosova duhet ta përmbush i dhash propozimet shumë konkrete të cilat i zgjidhin shumë prej problemeve edhe të mjedisit edhe të shpenzimeve tepër të mëdha të panevojshme në orientim kah energjia ripërtëritëse, sepse ajo është tepër më e shtrenjtët se sa energjia të cilën ne e posedojmë, prandaj mendoj se deklarimi i deputetit Beqaj ishte i pavend.

Fatmir Rexhepi -Të gjithë e dimë që Raporti i Progresit nuk është i lehtë por është i ngadalshëm për të gjitha ministrinë dhe shoqëritë në transicionin i kanë këto pengesa dhe shpresoj që të punojmë më shumë në mënyrë që të ecim përpara. E them këtë për arsye se janë sfida që janë në ekonomi. Rastin e energjisë, e cila përcillet tash 10 vite që nga vitit 2004, po bëhen 11 vite që nuk kemi ecur asnjë hap. Prandaj unë e kisha lutur ministrin që realisht të shikojë mundësitë e asaj alternativës që u përmend nga kolegët dhe e pyes ministrin, pse nuk po themelohet Bordi i AKP-së, dhe kjo ka qenë njëra prej vërejtjeve në Raportin e Progresit.

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, tha se janë pikërisht politikat ato që i japin përgjigjet për këto sfida. Nuk janë se këto sfida, janë diçka tjetër e politikat diçka tjetër dhe nuk po flasim për dy terrene por vetëm për një terren, kështu që ajo që lidhet me strategjinë, investitorë të caktuar, që janë pjesë e Bashkimit Evropian,. i kemi takuar dhe po flasim për shtetet që kanë rol ndikues dhe vendimmarrës në politikat e Bashkimit Evropian. Po bëhet një bujë e madhe, e që unë mendoj se janë mjaft mirë të qartësuara, dhe nëse ju pyet dikush a më mirë kjo apo kjo tjetra, e para nuk mund të shihet si konkurrencë nëpërmjet dy projekteve, mirëpo, nëse ne kemi një betejë me Bashkimin Evropian, për t'i plotësuar standardet dhe politikat ambientaliste, tash përnjëherë po thuhet se nuk ka konkurrencë, ku ne po flasim për dy kapacitete, që të dyja së bashku e bëjnë 1415 megavat, me çka? Me të ngjall. Tash ne kemi këtu edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të tjerë që janë kundër. Vetëm njërit projekt, ky është problemi ambientalist. Çështja e dytë është problemi financiar. Cilat janë institucionet financiare ndërkombëtare që do të mund të japin kredi për të dyja projekte, vlera e të cilave shkon në 2 miliard euro. I kemi tri pengesa; e para e natyrës politike, vendimi për dekomisionim le ta ndryshojnë, Raporti i Progresit le ta ndryshojë, le të thonë nuk duhet dekomisionim, duhet kjo. E dyta, modeli ligjor si? Pa procedurë apo kanë një model të partneriteti publiko privat. Në çka bazohet ligji? Nëse ka mangësi si do të ecë më tutje? Dhe e treta, financiar, nga shkurti deri me tani nuk kemi marrë përgjigje për mundësitë e financimit, as nga Banka Botërore, as nga Banka për Rindërtim dhe Zhvillim dhe as nga Banka Gjermane për Zhvillim. Lidhur me çështjen e hidroenergjisë, apo po shkoj me tutje për burimet e diversifikuara, siç e dini ne në fund të vitit e përfundojmë pjesën tonë të linjës së transmisionit 400 kilovolt. Jemi në kontakt me ambasadën angleze dhe atë amerikane. Do të ketë një studim të fizibilitetit, pastaj për atë që e vë në jetë këtë projekt e që është pika shkëmbyese, dhe mendoj se ne do të jemi të gatshëm që projekti që është pjesë e Traktatit dhe nga takimi që vi, kemi lëvdata për avancimet që kemi bërë nga ky projekt, pra në fund të tre mujorit të ardhëm ne do ta kemi të kryer linjën e interkonjeksionit.

Hanefi Muharremi, zv. ministër i Infrastrukturës, tha se në raport pikërisht kemi dhënë sfidat që i ka ministria. Ato i diskutuam dhe ato duhet të përmirësohen. Pyetja për patentë shofer, ne e diskutuam edhe më parë që ligji mbi siguri në komunikacion të ndahet në tri pjesë, që të jetë dhe ligji për patentë shofer. Ligji për patentë shofer do të jetë në mënyrë elektronike dhe pa pjesëmarrje të ekzaminuesve në sallë dhe se ky ligj i ri, më 1 janar do të funksionon dhe do të jetë mënyra tjetër e punës për patentë shofer. Sa i përket Merdares, ne nuk kemi nda ndonjë buxhet tani, por mbetet ashtu siç është por në të ardhmen do të kemi dhe kjo varet edhe prej punës, e cila do të përfitojë mjetet prej Bashkimit Evropian, në mënyrë që ajo autostradë të bashkohet (lidhet) me atë të Serbisë. Te hekurudhat është një projekt bukur kapital që nuk mundet Republika e Kosovës me buxhetin e vet ta përballojë, për atë arsye ne e kemi cekur se do t'i kemi 130 milionë nga grandi qeveritar nga fondi i Bashkësisë Evropiane në 50-50%, në mënyrë që të rregullohet hekurudha Hani i Elezit - Leshak, por kjo mbetet për vitin e ardhshëm.

Avni Kastrati, zv.ministër i Tregtisë dhe Industrisë, tha se pyetja që bëri deputeti Grainca, që potençoi se ka fatkeqësi në rrugë, unë këtë dua me e lidhë me pjesën që ne e mbulojmë. Pas 15 viteve e kemi licencuar një kompani që bënë verifikimin e pajisjeve, kontrollimi teknik, por ligji është i tillë që përveç se ne e autorizojmë, duhet edhe Ministria e Infrastrukturës të informojë rreth këtyre serviseve. U diskutua se ngritje të investimeve nuk ka, unë jam dakord, por ngritje të investimeve pa pako adekuate fiskale gjithashtu nuk ka. Çështja lidhur me naftën që është përmendur, Ligji i naftës pse nuk po procedohet, ne e kemi përgatitur dhe ai është në Qeveri. Trupat inspektuese nëpër pikat kufitare, jemi dakord dhe ne jemi duke i rishqyrtuar ato udhëzime administrative, por po dëshirojmë ta përshejtojmë, mos po bëhet edhe një gabim tjetër. Sa i përket kontrollimit të naftës që është vetëm 3%, unë mendoj se përgjegjësi e neve të gjithëve, në veçanti është e juve si deputetë ta analizoni se a jemi në gjendje ne si Kosovë ta rritim çmimin e naftës për 1 cent, që të mund ta kemi kontrollin 100%. Pyetja rreth rezervave të naftës, ne e kemi dhënë kërkesën, jemi të obliguar nga BE-ja deri në vitin 2020, mirëpo jemi refuzuar nga Ministria e Financave për shkak të financave se nuk ka mundësi tash për tash të krijojmë rezerva. Kemi shkuar me një kërkesë prej 15 milionë euro që dalëngadalë për shumë vite ose më mirë të themi për 10 vite të mbërrijmë në nivelin diku në 20-30 % të rezervave.

Sala Berisha – Shala - Ne jemi të gjithë të vetëdijshëm, pavarësisht prej pozicionit që kemi në institucionet e Kosovës. Ky raport tregon sfidat e progresit për Kosovën. Asnjëra palë nuk duhet të ndihemi fajtor apo epror karshi njëri-tjetrit, sepse sfidat në këtë raport janë edhe për Qeverinë në dikastere të posaçme, por janë edhe për Kuvendin. Kemi vërejtje edhe ne si Kuvend se nuk i kemi kryer obligimet tona, prandaj bashkërisht duhet që të ndihemi jo mirë se ende ballafaqohemi me sfida të tilla që na vlerëson Bashkimi Evropian neve si Kosovë. Mendoj se sot kjo pikë e rendit të ditës kaq e rëndësishme pa dashtë me i keqkuptuar zëvendësministrat, por është dashur që të jenë ministrat këtu që të japin sqarime. Falënderoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik rreth sqarimit për “Kosovës A”, për shkak se po ka dilema të mëdha në opinion, dilema ka pasur edhe në mes nesh. Ajo që më bëri përshtypje dhe e kërkoja fjalën, ne i kemi kaluar dy ligje në lexim të parë që vijnë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, që qëllimi i plotësimit ndryshimit të tyre ka qenë në bazë të arsyeshmërisë që e kanë dhënë ministri, se kërkohet nga Raporti i Progresit që Zyra të shndërrohet në Agjenci, këtu nuk e pash një kërkesë të tillë.

Blerim Grainca - Më duket se u keqkuptuam për çështjen e energjisë, shumica e deputetëve poentën e kishin tek ajo se a do të kemi mungesë të energjisë dhe a do të tejkalohet kriza? Pa dashur asnjë moment për të ndërhyrë në çështjet procedurale që i rregullon ligji, qoftë ai për partneritet publiko- privat, qoftë ai për financa publike, por ajo se a do të kemi rrymë apo nuk do të kemi.

Kryetari tha se të tri ministrinë kanë dhënë raporte shumë në detaje sipas sfidave, edhe Ministria e Zhvillimit që kemi marrë sot, edhe Ministria e Transportit, e edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. I falënderoj për korrektësi dhe efektivitet që t'i përgjigjen kërkesës sonë që t'i informojnë deputetët për sfidat. Mendoj që një reagim i tillë është për lëvdatë. E dyta, mendoj se diskutimi nuk ishte jashtë rendit të ditës për arsye se është shumë vështirë me i nda sfidat prej politikave dhe nuk është e mundur me i nda dhe pikërisht sfidat janë lidhur me politikat dhe lidhur me mënyrat e zbatimit të politikave. Çështja e energjisë dhe çështja e disponimit me energji mendoj se duhet të jetë prioritet kyç sepse ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" do të merr kohë dhe në ndërkohë, nëse dekomisionohet "Kosova A", ne do të kemi një "Gep", që është paraparë, në qoftë se "Kosova A" mbahet edhe shtatë vite kështu siç është sot, ky do të jetë dëmi më i madh sepse "Kosova A" sot është ndotësi kronik, prandaj këto janë çështje dhe hilemadhe ne presim shumë shpejt që ministria të na dërgojë strategjinë në aprovim në Kuvend. Një çështje që ka mbet për tu diskutua është çështja e normës së brendshme e kthimit. Është një çështje që i përket investitorit edhe i përket Kosovës sepse Kosova do të bëjë llogarinë për normën e brendshme të kthimit, por në kushtet normale asnjë investitori nuk mund t'i garantojmë normë të brendshme të kthimit. Normën e brendshme e kthimit e bënë investitori për vete, por jo ne të merremi vesh me investitorin se çfarë norme të brendshme të kthimit do të ketë, sepse nuk mund ti garantojmë investitorit normën e brendshme të kthimit. Çështja tjetër ka të bëjë me rritjen e konkurrencës, natyrisht energjia është shumë e rëndësishme për konkurrencën edhe karburantet, pra edhe energjia elektrike, prandaj sot me të drejt u përmend kjo punë. Ne duhet të dalim me analiza dhe ti ndërpresim këto situata dhe të themi se këto janë standardet kështu veprojmë, kështu kontrollohet, kështu kontrollohet në rajon, kështu po i kontrollojmë edhe ne, nuk mundemi në qoftë se diku tjetër bëhen laboratorët dhe testohet me 10 % dhe ne të mbesim me 3 %, ose diku 5 % , kjo nuk mund të tolerohet. Të çështja e konkurrencës së disa sektorëve, ne jemi të ndjeshëm aty dhe këtu kemi të bëjmë edhe me Ministrinë e Tregtisë si fjala vjen sektori i qumështit, po paraqitet sektori i naftës, sektori i ndërtimit etj. Ne duhet të shohim që të rritim aftësinë konkurruese dhe eksportet. Është mirë që janë zvogëluar subvencionet e ndërmarrjeve publike dhe ky është një sukses në Raportin e Progresit dhe kjo do të evidentohet. Mirëpo, ne e patëm çështjen e qumështit, ne mbesim pa një përgjigje të saktë, a ka të drejtë industria e qumështit apo nuk ka të drejt industria e qumështit, dhe si do ta aftësojmë industrinë e qumështit, që të jetë konkurrençe, pra duhet ti shkojmë deri në fund gjerave dhe të jemi më operativë.

Pas debatit Komisioni nxor këtë:

Përfundim

Komisioni në bazë të Planit të punës do të vazhdojë me prioritet të tij mbikëqyrjen dhe monitorimin nga afër punën e tri ministrive që ka në fushëveprim, në adresimin dhe përmbushjen e sfidave të paraqitura në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian dhe gjatë kësaj mbledhje.

4. Të ndryshme.

a) Hartimi i Projektligjit për Sigurinë në Punë në Miniera

Sala Berisha - Shala e njoftoi Komisionin lidhur me aktivitetet e nismës së Projektligjit për Sigurinë në Punë në Miniera. Dje tha ajo, e kemi mbajtur një punëtori dhe është diskutuar mjaftë rreth draftit që e ka sjell eksperti nga të pranishmit, si ministria, KPMM-ja dhe të ftuarit tjerë, dhe se para pushimeve do të përfundohet krejt ligji.

b) Gjendja në KEK

Sala Berisha - Shala e njoftoi Komisionin së është njoftuar nga menaxhmenti i KEK-ut, lidhur më shfrytëzimin e linjtit që po nxirret në mihjet e KEK-ut, ku kishin disa problem rreth këtyre mihjeve që po shfrytëzohen në mënyre të pakontrolluar linjiti dhe për këtë çështje kërkoi që të realizohet një vizitë në mihjet e KEK-ut.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa